



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR SHQYRTIMIN E PROPOZIMIT PËR NDRYSHIMIN E VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE TË ZAZ-SË NR. 4 DHE TË ZAZ-SË NR. 5, QARKU SHKODËR, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30.06.2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 28.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zëvendëskryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin e propozimit për ndryshimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së nr. 4 dhe ZAZ-së nr. 5, Qarku Shkodër, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1 germa "a", nenin 93 dhe 94, pika 1 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

V Ë R E N

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve:

me vendimin nr.261 datë 08.05.2019, ka caktuar VNV e KZAZ nr. 4 në Palestra e Shkollës 9-vjeçare "Xheladin Fishta", me sipërfaqe rreth 500 m², Bashkia Shkodër; me vendimin nr.262, datë 14.05.2019, ka caktuar VNV e KZAZ nr.5, në Palestrën pranë Shkollës 9-vjeçare "Ismail Qemali", me sipërfaqe 635 m².

Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresën drejtuar KQZ nr.12615, datë 28.06.2019, bazuar në përcaktimet e ligjit 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", në ushtrim të përgjegjësisë në situatën e krijuar, referuar shkresave të Kryetarit të Bashkisë Shkodër për lirimin e ambienteve në përgjegjësi administrimi të Bashkisë, si dhe shqetësimit të përcjellë nga KZAZ nr.4 dhe KZAZ nr.5, propozon ndryshimin e vendndodhjeve të:

VNV-së së ZAZ nr. 4, nga Shkolla 9-vjeçare "Xheladin Fishta", në Shkollën "Arben Broci", ambient me sipërfaqe 150 m², Bashkia Shkodër;



Nr. 918 i Vendimit Data 28.06.2019 e Vendimit Ora 14:30 e Vendimit

Për shqyrtimin e propozimit për ndryshimin e vendit të numërimit të votave të ZAZ-ve nr. 4 dhe ZAZ-së nr 5, Qarku Shkodër, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019

VNV-së së ZAZ nr. 5, nga Palestra pranë Shkollës 9-vjeçare "Ismail Qemali", në Shkollën "Arben Broci", ambient me sipërfaqe 150 m2, Bashkia Shkodër;

KQZ, në ushtrim të kompetencave përcaktuar në nenin 21, pika 3, të Kodit Zgjedhor, për kontrollin e procesit parazgjedhor dhe zgjedhor, vlerëson dhe shqyrton propozimin e paraqitur nga Prefekti i Qarkut Shkodër, objektet e propozuara të cilat plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor, kriteret e Udhëzimit nr. 4, datë 9.04.2015, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për mënyrën e caktimit dhe organizmit të Vendit të Numërimit të Votave, kriteret për caktimin e numrit të grupeve të numërimit për çdo vend të numërimit të votave, për caktimin e rregullave për ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupeve të numërimit".

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1 germa "a", nenin 93 dhe 94, pika 1 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar:

V E N D O S I

1. Të caktojë Vendin e Numërimit të Votave të ZAZ-së nr. 4, në Shkollën "Arben Broci", ambient me sipërfaqe 150 m2, Bashkia Shkodër.
2. Të caktojë Vendin e Numërimit të Votave të ZAZ-së nr.5, në Shkollën "Arben Broci", ambient me sipërfaqe 150 m2, Bashkia Shkodër.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zëvendëskryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare



Nr. 918 i Vendimit Data 28.06.2019 e Vendimit Ora 14:30 e Vendimit

Për shqyrtimin e propozimit për ndryshimin e vendit të numërimit të votave të ZAZ-ve nr. 4 dhe ZAZ-së nr 5, Qarku Shkodër, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019